



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:271644
Datë: 09.12.2022
Numri i dokumentit: 03736663

C.nr.1977/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirjeta Shala dhe me bashkëpunëtoren profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësve S.S, P.Z, Gj.L, Xh.A dhe I.Z, që të gjithë nga Gjakova, të cilët sipas autorizimit i përfaqësojnë Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson i autorizuari T.V, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 8,023.40 euro, jashtë seance me datë 09 Dhjetor 2022 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve S.S, P.Z, Gj.L, Xh.A dhe I.Z, që të gjithë nga Gjakova, me të cilën kanë kërkuar që të “*Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – DKA, që për periudhën kohore prej datës 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021, paditësve të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit të iu kompensojë shumat si në vijim : paditëses S.S shumën prej 1,549.80 euro, paditësit P.Z shumën prej 1,549.80 euro, paditëses Gj.L shumën prej 1,549.80 euro, paditësit Xh.A shumën prej 1,549.80 euro dhe paditësit I.Z shumën prej 1,824.20 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% e cila do të llogaritet nga dita e dorëzimit të kërkesës pranë të paditurës, si dhe shpenzimet procedurale*”

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësit S.S, P.Z, Gj.L, Xh.A dhe I.Z, që të gjithë nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 01.12.2021, përmes të autorizuarve të tyre Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – DKA, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësit janë punëtorë të SHFMU “Jahë Salihu” në Gjakovë. Sipas KKAK, neni 7 i kësaj kontrate përcakton se punëtorëve arsimor iu takon përqindja për kualifikim nga paga bazë dhe që nga koha e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate e deri më tani nuk është realizuar neni 7 i saj asnjëherë, duke bërë kështu që kontrata kolektive të mos ekzekutohet në tërësi. Andaj kanë

parashtruar padi ku kanë kërkuar që secilit paditës të iu paguhet kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit. Të autorizuarit e paditësve, përmes parashtresës kanë bërë precizimin e kërkesëpadisë, ashtu që për periudhën kohore nga data 08.10.2018 deri me datë 31.01.2021, në emër të diferencës në pagë, të detyrohet e paditura që paditëses S.S të ia paguajë shumën prej 1,549.80 euro, paditësit P.Z shumën prej 1,549.80 euro, paditëses Gj.L shumën prej 1,549.80 euro, paditësit Xh.A shumën prej 1,549.80 euro dhe paditësit I.Z shumën prej 1,824.20 euro, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% e cila do të lologaritet nga dita e dorëzimit të kërkesës pranë të paditurës, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj T.V, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 09.08.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk është nënshkruese e kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për t'i informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj. Po ashtu i njëjti është thirrur në parashkrim konform nenit 87 të Ligjit të Punës, ashtu që ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësve ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimin e padisë, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësve është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi, precizimin e padisë dhe përgjigje në padi, për gjykatën nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Jahë Saliu” në fshatin Molliq, Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës, të njëjtit realizojnë pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro, përveç paditësit I.Z që realizon pagë bazë me koeficient 7.8, dhe në emër të licencës për çdo muaj iu është paguar shuma prej 58.32 euro. Paditësit kanë diploma fakulteti, përkatësisht paditësja S.S ka diplomuar me datë 27.06.2015 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i Fizikë – Kimisë, paditësi P.Z ka diplomuar me datë 24.06.2015 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i Histori – Edukatë Qytetare, paditësja Gj.L ka diplomuar me datë 06.10.2012 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i Matematikë – Informatikës, paditësi Xh.A ka diplomuar me datë 01.03.2014 dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i Biologji – Kimisë si dhe paditësit I.Z ka diplomuar me datë 28.10.2004 dhe ka marrë kualifikimin Profesor i Biologjisë. Të gjithë paditësit kanë licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës.

Gjykata marrë parasysh kërkesën e paditësve, e po ashtu duke analizuar Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, në veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësit pretendojnë se iu takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, e ku kjo dispozitë përcakton se *“me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçare 27%*

të pagës bazë”, erdhi në përfundim se kërkesa e tyre është në tërësi e pabazuar për arsyet si në vijim:

Për gjykatën nuk është kontestuese që dispozitat e lartcekura kanë përcaktuar kompensimin për diferencën në pagë, mirëpo gjykata vlerëson se kjo dispozitë nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira në procesin e licencimit por që nga interpretimi i dispozitës se lartcekur shihet qartë që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar e asesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV të kësaj kontrate [RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE PAGAT], ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu që nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare të të paditurës: kompensimi për orët shtesë, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë të pranuar nga Enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të KKAK-së. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se *“Pagat e punëtoreve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.”*, andaj gjykata në rastin konkret nuk gjeti se me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, përpos që është përshkruar procedura e aplikimit për sistemin e licencimit dhe zhvillimit në karrierë të mësimdhënësve, janë listuar edhe akterët kryesor në zbatimin e këtij sistemi si dhe janë përcaktuar punët dhe detyrat e tyre, ashtu që në asnjërin prej tyre nuk parashihet obligimi taksativ për të ngritur pagat në shkallën siç është përcaktuar në nenin 7 të KKAK-së. Si rrjedhojë, nuk ka raport kontraktual në mes të palëve ndërgjyqëse apo dispozitë të karakterit obligativ që krijon të drejtën për paditësit e cila do të krijonte detyrimin për të paditurën që të kompensonte të njëjtit për këtë kriter të kompensimit.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi duke u bazuar në dispozitën e nenit 399 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtutjeshëm LPK), ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”,* edhe pse gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike pra faktin se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe se të njëjtit kanë të kryer nivelin Bachelor, mirëpo

kërkesëpadinë e tyre e refuzoi sepse e njëjta është qartazi e pathemeltë pasi që është e pabazuar në ligj apo akte tjera nënligjore në fuqi, e në mungesë të ndonjë akti tjetër juridik në fuqi që e njuh të drejtën e pretenduar nga paditësit, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 450 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
C.nr.1977/21, datë 09 Dhjetor 2022

Gj y q t a r ja,
Mirjeta Shala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.